

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 22 datë 17.12. 2025

**PËR PËRBËRJEN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË STREHIMIT SOCIAL
NË BASHKINË PËRMET**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenin 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 24, nenit 54, shkronja "k", të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 2, pika 51 të Ligjit Nr.22/2018 "Për strehimin social" i ndryshuar, Vendim Nr. 384, Datë 12.6.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi Social të Strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga Organet e Vetëqeverisjes Vendore", Vendim nr. 362, datë 29.5.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij", Vendim nr. 453, datë 3.7.2019 "Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti" VKM Nr 459 datë. 03.07.2019 "Për rregullat për Subvencionimin e qirasë dhe mënyrën e financimit", VKM Nr 405 datë 01.06.2016 "Për miratimin e strategjisë së stehimit social 2016-2025" pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Komisioni konsultativ i stehimit, Zyra e Shërbimeve Publike, dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë social, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

Të miratojë ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Strehimit Social në Bashkinë Përmet.

1. Pranë Bashkisë Përmet ngrihet dhe funksionon Komisioni i Strehimit Social.
2. Komisioni i Strehimit shqyrton dhe mer vendime në lidhje me kërkesat e paraqitura nga cdo subjekt që kërkon për të përfutuar nga njëri prej programeve sociale të strehimit, si dhe cdo çështje tjetër që parashikohet nga legjislacioni për strehimin apo akteve të tjera ligjore e nënligjore që përcaktojnë shqyrtimin e kërkesave nga ky komision.
3. Komisioni i strehimit përbëhet nga 5 anëtarë, si më poshtë:

1. Drejtori i Strukturës Përgjegjëse për Mbrojtjen dhe Përfshirjen Sociale.	Kryetar
2. Përfaqësues i Drejtorisë Juridike.	Anëtar
3. Përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit dhe Finances	Anëtar
4. Përfaqësues i zyrës së strehimit	Anëtar

5. Përfaqësuesi i Zyrës së NE & P.A.K

Anëtar

4. Komisioni i Strehimit asistohet nga Zyra për Çështjet Sociale dhe e Shërbimeve Publike të cilat asistojnë komisionin gjatë gjithë veprimtarisë së tij, dhe janë përgjegjëse për:

- a. Marrjen në dorëzim të aplikimeve dhe kërkesave që janë objekt i shqyrtimit dhe vendimmarrjes së Komisionit;
- b. Marrjen në dorëzim të aplikimeve dhe kërkesave që janë objekt i shqyrtimit dhe vendimmarrjes së Komisionit;
- c. Shpërndan dhe vë në dispozicion të anëtarëve, materialet për mbledhjen e radhës, brenda 5 ditëve pune para datës së mbledhjes;
- d. Njofton Kryetarin e komisionit për çdo kërkesë të paraqitur për shqyrtim dhe u njofton anëtarëve datën e marrjes në shqyrtim të kërkesës/aplikimit;
- e. Dhënie e mendimit kur i kërkohet nga komisioni, mendim i cili pasqyrohet në proces-verbalin e mbledhjes;
- f. Mban, harton dhe nënshkruan process-verbalin e mbledhjes;
- g. Zbardh vendimin e arsyetuar të marrë në mbledhjen e Komisionit;
- h. Ruan konfidencialitetin.
- i. Çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga Kryetari apo Komisioni i Strehimit.

5. Drejtoria Juridike, e Aseteve dhe Licencimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar të caktojnë përfaqësuesit e tyre në këtë komision.

6. Ngarkohen Komisioni i Strehimit, Nënkryetari i Bashkisë, Zyra e Shërbimeve Sociale, Zyra e Financës, Zyra e Shërbimeve Publike Zyra Juridike, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Zyra e Nd.Ekonomike dhe Kujdesit Social për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

7. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE



KRYETAR
Anila DHIMITRI

